



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 346/4 prot.

Tiranë më 23.2.2018

REKOMANDIM

Nr. 07, datë 23.2.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*".

Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.65, datë 12.02.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Zyra Përmbartimore Elbasan, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Zyra Përmbartimore Elbasan.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr. 65, datë 12.02.2018 të Komisionerit.

Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë. Ky shërbim, ka organizim unik dhe të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kontrolluesi Zyra Përmbartimore Elbasan, në ushtrim të veprimtarisë së saj, ka kryerjen e shërbimit përmbartimor gjyqësor dhe konkretisht, ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, si marrjen e fëmijës dhe lejimin e së drejtës së vizitës, tek njëri prind, në rastet e zgjidhjes së martesës, zbatimin e një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv me objekt të pa vlerësueshëm,

nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar, për vënien në posedim të sendit të luajtshëm, për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, në rastin e ekzekutimit të një vendimi për sigurimin e padisë ose me revokimin e saj, etj.

Pra, gama e të dhënave që mbledhen gjatë ushtrimit të aktivitetit përbarimor është shumë e gjerë.

Në ligjin organik të shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror, Nr.8730, datë 18.1.2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror", neni 26 i tij "Mbledhja dhe administrimi i të dhënave", shprehet:

"1. Përbaruesi gjyqësor ka të drejtë dhe merr masa për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen ngushtë me nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara, duke respektuar garancitë kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Organet e administratës publike dhe të sistemit të drejtësisë, entet publike, si dhe personat fizikë e juridikë që kanë dokumente dhe të dhëna që lidhen me ekzekutimin, janë të detyruar t'i paraqesin kur u kërkohen nga përbaruesit gjyqësorë.

3. Të dhënat e marra në përputhje me këtë nen grumbullohen, administrohen, ruhen dhe/ose asgjësohen, në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi".

Ky nen i jep përbaruesit gjyqësor të drejtën e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave për nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara, duke patur parasysh respektimin dhe garancitë kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Zyra Përbarimore Elbasan, është kontrollues i cili mbledh dhe grumbullon të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe përbarues gjyqësor" dhe "subjekte që marrin pjesë në ekzekutim".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, në datë 20.02.2018 u konstatua:

1. Kontrolluesi Zyra Përbarimore Elbasan, nuk disponon rregullore për mbledhjen përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi Zyra Përbarimore Elbasan, nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi Zyra Përbarimore Elbasan, dosjet përbarimore i ka të pa sistemuara sipas kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

Përfaqësuesja e kontrolluesit, Zyra Përbarimore Elbasan, nuk paraqiti pretendime në lidhje me konstatimet e shprehura dhe të lexuara në prani të palëve të procesverbalit në fjalë, por u shpreh si vijon:

"Për sa i përket dosjeve, janë të pa sistemuara sipas rregullave për shkak të mungesës së ambienteve. Jemi në pritje nga Ministria e Drejtësisë për tu sistemuar".

Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Zyra Përmbartimore Elbasan, të hartojë Rregulloren për "*Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale*". Gjithashtu, Zyra Përmbartimore Elbasan, në bashkëpunim me institucionin epror Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit Shtetëror, të marrë masa për sistemin e dosjeve të cilat përmbajnë vendime ekzekutive, dhe të dhëna personale të "*subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim*".
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Zyra Përmbartimore Elbasan, të nënshkruajë "*Deklaratat e Konfidencialitetit*" me punonjësit dhe përmbartuesit gjyqësor, sipas standardit të përcaktuar në Vendimin Nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit, për "*Përcaktimin e rregullave të Hollësisë për Sigurimin e të Dhënave Personale*".
3. Kontrolluesi Zyra Përmbartimore Elbasan, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 23/2/2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

